

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BESTBIO” Sh.p.k.**

Sot më datë 10.10.2018, Altin Bushka, lindur në Vranisht, Devoll, më 13.04.1975, banues në Tiranë mbajtës i letërmjofimit nr. H50413200B , madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë “Shtojca 1”).

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “**BESTBIO**” Sh.p.k.

Neni 2 - Adresa

Selia e Shoqërisë është në, Fshati Mumajes, Rrethi Tiranë, Zona Kadastrale 2736, Numër Pasurie 94/26.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor të saj prodhimin, riprodhimin, inkubacionin, rritjen, therjen, përpunimin, konservimin, shitjen dhe blerjen brenda dhe jashtë vendit të produkteve të freskëta, të ngira dhe të mbingrrira, import shitje dhe blerje brenda dhe jashtë vendit të shpendëve kafshëve vezëve mishit qumështit dhe nënprodukteve e tyre.
- 4.2 Shitje dhe blerje brenda dhe jashtë vendit te impianteve makinerive, lëndëve të para ambalazheve ushqimeve për kafshët dhe shpendët, produkte farmaceutike qe lidhen me ketë aktivitet.
- 4.3 Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitet për llogari të të tretëve, lidhur me aktivitetet më sipër.
- 4.4 Shoqëria do të mund të blejë, pjesëmarrje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, të themeluara apo në themelim, të cilat kanë objekt të ngashëm apo sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes së qëllimeve të shoqërisë.
- 4.5 Shoqëria, përfundimisht, realizon aktivitetet përgjithësia, që ka të bëjë me pasurinë e luajtshme, të paluajtshme apo financiare që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, përfshirë këtu, por pa u limituar në të, nënshkrimin e marrjes së kredive me institucionet e autorizuara nga ligji si dhe me shoqëri dhe ndërmarrje private.
- 4.6 Shoqëria do të mund të kryejë çdo veprim që ka të bëjë me pasurinë e luajtshme, të paluajtshme apo financiare që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, përfshirë këtu, por pa u limituar në të, nënshkrimin e marrjes së kredive me institucionet e autorizuara nga ligji si dhe me shoqëri dhe ndërmarrje private.
- 4.7 Më në përgjithësi, Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm përmes përbushjen e qëllimeve të shoqërisë.
- 4.8 Shoqëria nuk mund të zhvillojë aktivitet që shkel ligjin shqiptar në fuqi.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e nënshkruar dhe e shlyer, me vlerë nominale 100 (njëqind) Lekë.

Neni 6 – Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
 - Z. Altin Bushka, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me Lekë 100 (njëqind), nëpërmjet depozitimit pranë llogarisë bankare në favor të shoqërisë në themelim e sipër.
- 6.2 Sipas kontributit të mësipërm:
 - Z. Altin Bushka, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat transferohen sipas mënyrave të parashikuara në Statut.

Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë, personi si më poshtë:
 - Z. Altin Bushka, lindur në Vranisht, Devoll, më 13.04.1975, banues në Tiranë mbajtës i letërnjoftimit nr. H50413200B.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtarë” dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit u jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund ti drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori njëkohësisht Ortak i Vetëm vepron në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjera.



Neni 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.
- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërisht detyrues.

ORTAKU I VETEM
Altin Bushka

Altin Bushka

~~A~~